



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1237

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) PRO MEDICAL SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit, Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të KOMUNA E VUSHTRRIË, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Servisimi dhe mirëmbajtja e paisjeve mjekësore për nevojat e QKMF Dr. Safet idrizi Vushtrri. me numër të prokurimit 644-25-8559-2-2-1, me 03.02.2026 mori:

Vendim

1. Aprovohen, si të bazuara ankesat e OE PRO MEDICAL SH.P.K., me nr. 2025/1237, e datës 18.12.2025, PRO MEDICAL SH.P.K., me nr. 2025/1250, e datës 21.12.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Servisimi dhe mirëmbajtja e paisjeve mjekësore për nevojat e QKMF Dr. Safet idrizi Vushtrri. me numër të prokurimit 644-25-8559-2-2-1.

2. Anulohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të KOMUNA E VUSHTRRIË, ndërkaq aktiviteti i prokurimit Servisimi dhe mirëmbajtja e paisjeve mjekësore për nevojat e QKMF Dr. Safet idrizi Vushtrri. me numër të prokurimit 644-25-8559-2-2-1 kthehet në **Rivlerësim për Lot I dhe Lot II**.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik PRO MEDICAL SH.P.K., PRO MEDICAL SH.P.K. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 22.09.2025, KOMUNA E VUSHTRRIË., në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Servisimi dhe mirëmbajtja e paisjeve mjekësore për nevojat e QKMF Dr. Safet idrizi Vushtrri. me numër të prokurimit 644-25-8559-2-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurën e hapur**, lloji i kontratës: **shërbim**, vlera e parashikuar e kontratës: **108,000.00€ ndërsa Lot 1-72,000.00€. ndërsa Lot 2- 36,000.00€.**

Me 05.12.2025 AK KOMUNA E VUSHTRRIË., ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 ku e ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Me 08.12.2025, OE PRO MEDICAL SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Me datë 10.12.2025 po ashtu edhe OE PRO MEDICAL SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me 08.12.2025 dhe 11.12.2025 Autoriteti Kontraktues ka publikuar vendimin përmes të cilit refuzohen si të pa bazuara ankesat e të dy Operatorëve Ekonomik dhe vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me 18.12.2025, OE PRO MEDICAL SH.P.K., ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 1237/2025 ndërsa me datë 21.12.2025 OE PRO MEDICAL SH.P.K., ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 1250/2025.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 0535/2025 dhe ankesa nr. 0560/2025 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues PRO MEDICAL SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë, në aktivitetin e prokurimit “Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore për nevojat e QKMF ‘Dr. Safet Idrizi’ Vushtrri – Lot II”, në procedurën e lartshënuar, ka rekomanduar OE PRO MEDICAL SH.P.K., pra ankuesin, si fitues për Lot II me vendimin e datës 29.10.2025, ku për këtë lot është dorëzuar vetëm një ofertë.

Ne, me datë 26.11.2025, kemi dërguar kërkesë me shkrim (email) pranë Autoritetit Kontraktues (AK), me të cilën kemi kërkuar që të na dërgohet draft-kontrata për Lot II, ashtu siç parashihet në Rregulloren për Prokurimin Publik (RRPP), neni 21.8. Kjo kërkesë është bërë duke marrë parasysh faktin se nuk ka pasur asnjë ankesë dhe se të gjitha afatet ankimore kanë përfunduar, mirëpo deri më tani nuk kemi pranuar asnjë përgjigje nga AK lidhur me këtë çështje, ndërsa me datë 26.11.2025 Autoriteti Kontraktues ka dërguar njoftimin paraprak për anulimin e tenderit (shih Provën 1).

Pavarësisht kësaj, anulimi zyrtar nga AK është bërë me vendimin e datës 05.12.2025, i cili bie ndesh me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), konkretisht me nenin 62, pasi një veprim i tillë përbën shkelje flagrante të dispozitave ligjore. Ky vendim është i pambështetur juridikisht dhe, për nga natyra, paraqet vendim arbitrar, duke mos respektuar kriteret dhe kushtet e parashikuara në nenin 62 të LPP-së.

AK, me vendimin e datës 05.12.2025, ka anuluar në tërësi tenderin, pa pasur asnjë kërkesë për rishqyrtim lidhur me Lot II.

Kjo ngrit dyshime serioze procedurale, pasi:

të gjitha fazat e prokurimit për Lot II kanë përfunduar në mënyrë të rregullt;

nuk ka pasur Kërkesë për Rishqyrtim nga asnjë Operator Ekonomik (nuk ka pasur palë interesi);

kanë kaluar të gjitha afatet ligjore për paraqitjen e KPR-ve (Kërkesë për Rishqyrtim);

AK ka rikthyer në rivlerësim një lot pa asnjë bazë ligjore.

Është e paqartë dhe në kundërshtim me LPP-në se si është e mundur që AK të anulojë një aktivitet prokurimi, të rikthejë në rivlerësim Lot II dhe të anashkalojë rezultatin e vlerësimit, pa pasur kërkesë për rishqyrtim dhe pa ndonjë arsye ligjore të arsyetuar. Secili lot përbën një kontratë të veçantë dhe AK nuk mund të anulojë apo rivlerësojë një lot në mungesë të një Kërkese për Rishqyrtim specifike për atë lot.

Veprimi i AK bie në kundërshtim me:

Nenin 7 – Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit, pasi ne, si OE, jemi vendosur në pozitë të pafavorshme pa asnjë shkak ligjor dhe jemi diskriminuar;

Nenin 59 – Procedura e vlerësimit është zbatuar në përputhje me parimet e LPP-së. Rivlerësimi i një loti pa paraqitjen e një Kërkese për Rishqyrtim konsiderohet veprim arbitrar dhe i paarsyetuar, i cili shkel parimet e barazisë, transparencës dhe konkurrencës.

Me publikimin e B58 të datës 29.10.2025, faza e vlerësimit të prokurimit ka përfunduar zyrtarisht. Nga ky moment, afati për ankesa ose kërkesa për rishqyrtim zbatohet sipas nenit 108/A të LPP-së dhe, në rastin konkret për Lot II, nuk ka pasur asnjë palë të interesuar.

Ritheksojmë se, me datë 05.12.2025, AK ka publikuar vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit në tërësi, duke përfshirë edhe Lot II, ndonëse për Lot II nuk ka pasur asnjë kërkesë për rishqyrtim. Vendimi është publikuar duke u thirrur në nenin 62 të LPP-së, të cilin, sipas vlerësimit tonë, AK e ka interpretuar gabimisht.

Shkeljet e LPP-së nga Autoriteti Kontraktues janë si vijon:

Neni 1 – Qëllimi E kundërshtojmë vendimin e Autoritetit Kontraktues, ngase i njëjti është në kundërshtim me nenin 1 të Ligjit për Prokurimin Publik. AK ka shkelur nenin 1, paragrafi 2 të LPP-së, i cili përcakton se ky ligj ka për qëllim të sigurojë integritetin, përgjegjësinë, mosdiskriminimin dhe transparencën në vendimmarrje, si dhe përputhshmërinë me kërkesat procedurale dhe qenësore të ligjit.

Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve Autoriteti Kontraktues, duke zbatuar procedurën e vlerësimit sipas nenit 59 të LPP-së, ka rekomanduar dhënien e kontratës Operatorit Ekonomik Pro Medical më datë 29.10.2025. Për Lot II nuk ka pasur asnjë kërkesë për rishqyrtim, pasi ka qenë vetëm një ofertë e dorëzuar. Prandaj, nuk qëndron arsyetimi i AK-së se lënda është kthyer në rivlerësim pas një kërkesë për rishqyrtim (shih Provën 2).

Edhe vendimi i AK-së i datës 05.12.2025 tregon qartë se për Lot II ka qenë vetëm një ofertë dhe nuk ka pasur asnjë kërkesë për rishqyrtim. Për këtë arsye, anulimi i Lot II paraqet anomali procedurale dhe është në kundërshtim me dispozitat e LPP-së. Ritheksojmë se vendimi i AK-së (B58) është publikuar më datë 29.10.2025. Pas publikimit ka kaluar periudha ligjore e pritjes prej 5 ditësh për kërkesa për rishqyrtim, dhe në rastin konkret nuk ka pasur asnjë të tillë. Prandaj, AK ka qenë i obliguar të përgatisë dhe publikojë draft-kontratën dhe ta përcjellë për nënshkrim.

Arsyetimi i AK-së në vendimin e datës 05.12.2025 nuk qëndron dhe është mbështetur gabimisht në nenin 9 të LPP-së, i cili ka të bëjë me fazën para inicimit të aktivitetit të prokurimit dhe jo me fazën e rivlerësimit. Po ashtu, referimi në nenet 8.1 dhe 8.5 të Rregullores Nr. 001/2022, të ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, është i pabazuar, pasi këto dispozita lidhen me kushtet para inicimit të prokurimit dhe jo me ndërhyrje pas përfundimit të vlerësimit. Në këtë rast, AK nuk ka pasur asnjë bazë ligjore për anulim sipas nenit 62 të LPP-së, pasi: mjetet financiare kanë qenë të disponueshme; procedura është zhvilluar konform LPP-së, pa shkelje të pakorrigjueshme. Kontrata është Kontratë Publike Kornizë – shërbim për periudhë 36-mujore, që përfshin shërbime esenciale dhe sensitive për pacientët.

Nga dokumentet e siguruar rezulton se mjetet buxhetore kanë qenë të planifikuara dhe të zotuar në kodin buxhetor 014050, në vlerë prej 66,574.00 euro për çdo vit për periudhë trevjeçare. Për vitin 2025 janë planifikuar mjete në vlerë prej 58,124.00 euro, një pjesë e të cilave janë shpenzuar nga kontrata paraprake (shih Provën 4).

Buxheti për vitin 2026 është aprovuar nga KK Vushttrisë dhe mjetet janë të zotuar, prandaj arsyetimi se nuk mund të alokohen fonde financiare nuk qëndron.

Si pasojë, Pro Medical është diskriminuar në këtë aktivitet të prokurimit, ndonëse ka përmbushur të gjitha kërkesat ligjore. Vendimi për anulim është marrë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të RRPP-së Nr. 002/2024.

Veprimi i AK-së bie në kundërshtim me nenet 43.5 dhe 43.7 të Rregullores Nr. 002/2024, si dhe me nenin 7 të LPP-së. Arsyetimi i dhënë nuk përfshihet në asnjë nga rastet e lejuara për anulim.

Për këtë arsye, kërkojmë që të anulohet Vendimi i datës 05.12.2025 dhe të mbetet në fuqi Vendimi i datës 29.10.2025 për Lot II, në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues PRO MEDICAL SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë, në aktivitetin e prokurimit “Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore për nevojat e QKMF ‘Dr. Safet Idrizi’ Vushtrri – Lot I”, në procedurën e lartshënuar, ka rekomanduar OE ATOM-MED për Lot I me vendimin e datës 29.10.2025.

Pas vlerësimit të ofertave, AK më datë 29.10.2025 ka publikuar B58 – Njoftimin për Vendimin e AK-së, ku ka shpallur fituesit e përkohshëm: o ATOM-MED për Lot 1.

Me datë 03.11.2025, ne kemi paraqitur Kërkesën për Rishqyrtim për Lot 1, në pajtim me nenin 60 të Rregullores Nr. 001/2022, të plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024. Me datë 05.11.2025, Autoriteti Kontraktues ka miratuar pjesërisht kërkesën tonë për rishqyrtim dhe ka vendosur që lënda të rikthehet në rivlerësim.

Në Kërkesën për Rishqyrtim kemi theksuar se eliminimi ynë është bërë në kundërshtim me LPP-në, konkretisht me nenin 59, pasi ne kemi përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara sipas Dosjes së Tenderit (DT) dhe Njoftimit për Kontratë (NJK).

Kjo është konstatuar edhe nga vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës 05.11.2025, me të cilin lënda është rikthyer në rivlerësim (shih Provën 1).

Megjithatë, më datë 26.11.2025, Autoriteti Kontraktues ka dërguar njoftimin paraprak për anulimin e tenderit (shih Provën 2).

Pavarësisht kësaj, anulimi zyrtar nga AK është bërë me vendimin e datës 05.12.2025, i cili bie ndesh me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), konkretisht me nenin 62, pasi një veprim i tillë përbën shkelje flagrante të dispozitave ligjore. Ky vendim është i pambështetur juridikisht dhe, për nga natyra, paraqet vendim arbitrar, duke mos respektuar kriteret dhe kushtet e parashikuara në nenin 62 të LPP-së (shih Provën 3).

Kërkesën e dytë për Rishqyrtim për Lot 1 e kemi parashtruar me datë 10.12.2025, ndërsa Autoriteti Kontraktues (AK) e ka refuzuar atë me vendim të datës 11.12.2025. Vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim paraqet paqartësi dhe anomali të theksuara, pasi arsyetimi i dhënë bie ndesh me pretendimet tona. Për më tepër, në arsyetim AK është fokusuar në Lot 2, ndërkohë që kërkesa jonë ka të bëjë ekskluzivisht me Lot 1.

Si rrjedhojë, vendimi në fjalë nuk paraqet gjendjen faktike dhe reale të çështjes, duke mos adresuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet tona lidhur me Lot 1.

Arsyetimi i AK-së në Vendimin për Anulim të datës 05.12.2025 (Prova 5) është mbështetur gabimisht në nenin 9 të LPP-së dhe nuk qëndron, pasi paragrafi 1 i këtij neni përcakton qartë: “Para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit...”, e jo në fazën e rivlerësimit, ashtu siç pretendon AK. Për rrjedhojë, interpretimi i AK-së është i pasaktë dhe i përdorur në mënyrë të gabuar për të justifikuar anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Po ashtu, arsyetimi i AK-së i bazuar në nenet 8.1 dhe 8.5 të Rregullores Nr. 001/2022, të plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, nuk qëndron, pasi këto dispozita të rregullores kanë të bëjnë me kushtet dhe procedurat para inicimit të prokurimit dhe jo me

ndërhyrje gjatë procesit të rivlerësimit pas një kërkesë për rishqyrtim. Për këtë arsye, referimi i AK-së ndaj këtyre neneve është i pambështetur juridikisht dhe bie ndesh me kuadrin ligjor të prokurimit publik, pasi ato zbatohen para fillimit të ushtrimit të aktivitetit të prokurimit e jo, siç pretendon AK, gjatë rivlerësimit.

Në këtë rast, AK nuk ka pasur asnjë bazë ligjore për anulim sipas nenit 62 të LPP-së, sepse: mjetet financiare kanë qenë plotësisht të disponueshme për këtë aktivitet të prokurimit; procedura është inicuar dhe zhvilluar konform LPP-së, pa asnjë indikator të shkeljes së pakorrigjueshme. Kjo është Kontratë Publike Kornizë – shërbim për periudhë 36-mujore, prandaj nuk kemi të bëjmë me furnizim apo punë, por me shërbime esenciale dhe sensitive që ndikojnë drejtpërdrejt te pacientët.

Pas parashtrimit të kërkesës për qasje në dokumente publike pranë institucionit përkatës, kemi siguruar se për projektin në fjalë kanë qenë të planifikuara, të siguruar dhe të zotuar mjetet buxhetore, të evidentuara në kodin buxhetor 014050, i cili bën pjesë në kategoritë e shpenzimeve buxhetore sipas klasifikimit ekonomik. Pra, mjetet buxhetore në vlerë prej 66,574.00 euro kanë qenë të planifikuara për çdo vit për një periudhë trevjeçare, ndërsa procesi i zotimit dhe planifikimit të tyre është realizuar në baza vjetore, në përputhje me planifikimet dhe ndarjet buxhetore të miratuara (Prova 4).

Sa për informim, buxheti i vitit 2026 është aprovuar nga Kuvendi Komunal i Vushtrisë dhe aktualisht ndodhet në MFPT për t'u futur në BDMS dhe PIP, pasi nuk është aprovuar brenda afateve ligjore; pra, mjetet janë të zotuar dhe të buxhetuara.

Megjithatë, AK ka tentuar ta arsyetojë anulimin duke u mbështetur në nenin 62, paragrafi 1.1 të LPP-së, i cili përcakton: “kur një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit...”.

Në rastin konkret, nuk ekziston asnjë shkelje e tillë, as e ndodhur dhe as e parashikuar, e cila nuk mund të rregullohej apo të parandalohet. Prandaj, referimi i AK-së në nenin 62, paragrafi 1.1 është juridikisht i pavlefshëm dhe i pambështetur në fakte konkrete.

Në rastin konkret, Pro Medical është vendosur në një pozicion të pafavorshëm pa asnjë shkak ligjor, pasi:

në Lot 1, kompania jonë është eliminuar pa bazë ligjore, ndërsa një operator tjetër, ATOM-MED, është rekomanduar për kontratë, edhe pse mjetet financiare ishin të disponueshme;

pas Kërkesës për Rishqyrtim për Lot 1, kur gjendja faktike ka ndryshuar, AK ka marrë vendim për anulimin e prokurimit, duke e penalizuar Pro Medical.

Këto veprime përbëjnë diskriminim të qartë nga AK, në shkelje të nenit 7 të LPP-së, pasi kompania jonë është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të pafavorshme pa asnjë arsye ligjore.

Shkeljet e tjera të LPP-së nga Autoriteti Kontraktues janë si vijon:

Neni 1 – Qëllimi

E kundërshtojmë vendimin e Autoritetit Kontraktues, ngase i njëjti është në kundërshtim me nenin 1 të Ligjit për Prokurimin Publik. AK ka shkelur nenin 1, paragrafi 2 të LPP-së, i cili

përcakton që ky ligj ka për qëllim të sigurojë integritetin, përgjegjësinë, mosdiskriminimin dhe transparencën në vendimmarrje.

Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Sipas nenit 59 të LPP-së, AK është i obliguar të kryejë vlerësimin e ofertave në përputhje me dispozitat ligjore dhe kushtet e përcaktuara në DT dhe NJK. Vetëm në rast se asnjë OE nuk përmbush kriteret, AK mund të anulojë procedurën, gjë që në rastin konkret nuk aplikohet.

Për rrjedhojë, kërkojmë anulimin e Vendimit të datës 05.12.2025 dhe respektimin e plotë të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullores Nr. 002/2024.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për PRO MEDICAL SH.P.K.,

1. Objekti i shqyrtimit OE “PRO MEDICAL” SH.P.K. ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 05.12.2025, me të cilin është marrë vendimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit “Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore – Lot 1 dhe Lot 2”.

2. Qëndrimi i Autoritetit Kontraktues Pas shqyrtimit të kërkesës së OE-së, Autoriteti Kontraktues vlerëson se Kërkesa për Rishqyrtim është e pabazuar dhe se vendimi i datës 05.12.2025 për anulimin e aktivitetit të prokurimit është marrë në përputhje të plotë me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Rregulloren Nr. 002/2024.

3. Baza ligjore për anulim (shkaku real dhe i dokumentuar)3.1. Neni 62 i Ligjit për Prokurimin Publik – Përfundimi i aktivitetit të prokurimit

Neni 62, pika 1.1 e LPP-së përcakton qartë se:“Aktiviteti i prokurimit mund të përfundohet me anulim nëse Autoriteti Kontraktues nuk ka financim të mjaftueshëm për ta realizuar kontratën.”

Në rastin konkret: Për vitin 2025 nuk ka asnjë mjet të zotuar për Lot 1 dhe Lot 2.Drejtoria e Financave e ka njoftuar AK-në me shkrim për mungesë buxheti dhe për pamundësi të nënshkrimit të kontratës. Është konfirmuar nga ZKA, ZKF dhe ZPP se ka ndryshuar gjendja financiare si rezultat i përmbarimeve, konform nenit 40 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike.Kjo përbën bazë të drejtpërdrejtë ligjore për anulim, e paraparë shprehimisht nga LPP-ja.

3.2. Neni 43.7 i Rregullores Nr. 002/2024 Neni 43.7 autorizon AK-në që, pas hapjes së ofertave, të anulojë procedurën “nëse çmimet e ofertave tejkalojnë buxhetin e planifikuar dhe të zotuar për këtë kontratë”.Në këtë rast:AK nuk ka pasur fare buxhet të zotuar, as të mjaftueshëm e as minimal. Procedura kornizë 36-mujore kërkon zotim vjetor buxheti, të cilin AK nuk e ka pasur.

Pra, edhe me vetëm një ofertë të përgjegjshme, mungesa e buxhetit paraqet shkak ligjor për anulim.

4. Sqarimi ndaj pretendimeve të OE-sëPretendimi 1: “Të gjitha fazat e vlerësimit kanë përfunduar dhe Lot 2 nuk ka pasur ankesë.”Po, vlerësimi për Lot 2 ka përfunduar.Megjithatë, përfundimi i vlerësimit nuk e obligon AK-në të nënshkruajë kontratë në mungesë të mjeteve buxhetore.Neni 62 i LPP-së është normë e posaçme (lex specialis) që prevalon ndaj fazës së vlerësimit.

Konkluzion:Përfundimi i vlerësimit nuk e kufizon kompetencën e AK-së për të anuluar aktivitetin e prokurimit në mungesë të buxhetit.Pretendimi 2: “AK ka qenë i obliguar të dërgojë draft-kontratën.”Jo.Sipas nenit 21.8 të Rregullores, draft-kontrata dërgohet vetëm pasi AK konfirmon se ekziston mbulimi buxhetor.Në mungesë të buxhetit: Draft-kontrata nuk mund të publikohet.Nënshkrimi i kontratës në mungesë buxheti përbën shkelje të Ligjit për Financat Publike dhe përgjegjësi disiplinore dhe penale për Zyrtarin Kryesor Administrativ dhe Zyrtarin Kryesor Financiar.

Pretendimi 3: “Kontrata kornizë 36-mujore mund të ekzekutohet edhe me mjete të pjesshme.”Ky pretendim nuk është i saktë.Sipas udhëzimeve të MF-së: Kontratat kornizë nënshkruhen vetëm nëse ka planifikim të fondeve për vitin e parë dhe zotim për vitet pasuese.AK nuk ka pasur asnjë vlerë në dispozicion.Prandaj, kontrata nuk ka mundur të nënshkruhet.

Pretendimi 4: “AK ka diskriminuar OE-në.”Vendimi për anulim ka qenë i njëjtë për të dy lotët. Shkaku ka qenë mungesa e mjeteve financiare dhe jo OE-ja.Nuk ekziston asnjë element për trajtim të pabarabartë apo diskriminim.

5. Konkluzioni juridikBazuar në:– Nenin 62 të LPP-së,– Nenet 43.5 dhe 43.7 të Rregullores Nr. 002/2024,– Ligjin mbi Financat Publike,– Njoftimin zyrtar të Drejtorisë së Financave për mungesë buxhetore,Autoriteti Kontraktues ka vepruar:

brenda kompetencave ligjore, në mënyrë të paanshme,duke shmangur dëmin financiar ndaj Komunës,në respektim të ligjit dhe parimeve të menaxhimit të parasë publike.

6. Vendimi i Autoritetit KontraktuesKërkesa për rishqyrtim e OE “PRO MEDICAL” SH.P.K. REFUZOHET si e pabazuar.Mbetet në fuqi vendimi i AK-së i datës 05.12.2025 për anulimin e aktivitetit të prokurimit.Arsyetimi ligjor:Anulimi është bërë në bazë të nenit 62.1.1 të LPP-së – mungesa e mjeteve financiare, si dhe nenit 43.7 të Rregullores Nr. 002/2024.

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë (në tekstin e mëtejme AK), në bazë të kërkesës së Njesisë Kërkuese, ka inicuar aktivitetin e prokurimit me titull: “Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore për nevojat e QKMF ‘Dr. Safet Idrizi’ Vushtri”, me kod intern të procedurës 644-25-8559-2-2-1.Në fund, AK thekson se vërtetohen dhe mbesin në fuqi të gjitha kërkesat, kushtet dhe informatat përkatëse të dosjes së tenderit, duke përfshirë Njoftimin për Anulim B-58, me arsyetimin se të njëjtat garantojnë transparencë, konkurrencë dhe trajtim të barabartë për të gjithë OE-të që zotërojnë kapacitetet e nevojshme, në përputhje me objektin dhe specifikat e fushëveprimtarisë, në funksion të realizimit të suksesshëm të kontratës.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për PRO MEDICAL SH.P.K.,

4. Sqarimi ndaj pretendimeve të OE-së

Pretendimi 1: “Të gjitha fazat e vlerësimit kanë përfunduar dhe Lot 2 s’ka pasur ankesë.”Po, vlerësimi për Lot 2 ka përfunduar.Por vlerësimi nuk e obligon AK-në të nënshkruajë kontratë, nëse nuk ka mjete buxhetore.Neni 62 i LPP-së është normë e posaçme (lex specialis), që prevalon ndaj fazës së vlerësimit.

Konkluzion:Përfundimi i vlerësimit nuk e kufizon kompetencën e AK-së për të anuluar AP-në në mungesë të buxhetit.Pretendimi 2: “AK ka qenë i obliguar të dërgojë draft-kontratën.”Jo.Sipas

Nenit 21.8 të Rregullores, draft-kontrata dërgohet vetëm pasi AK konfirmon se ekziston mbulimi buxhetor. Në mungesë të buxhetit: Draft-kontrata nuk mund të publikohet. Nënshkrimi i kontratës në mungesë buxheti përbën shkelje të ligjit të financave publike dhe përgjegjësi disiplinore dhe penale për Zyrtarin Kryesor Administrativ dhe Zyrtarin Kryesor Financiar.

Pretendimi 3: “Kontrata kornizë 36-mujore mund të ekzekutohet edhe me mjete të pjesshme.” Kjo nuk është e saktë. Sipas Udhëzimit të MF-së: Kontratat kornizë nënshkruhen vetëm nëse ka planifikim të fondeve për vitin e parë dhe zotim për vitet pasuese. AK nuk ka pasur asnjë vlerë në dispozicion. Prandaj, kontrata nuk mund të nënshkruhet.

Pretendimi 4: “AK ka diskriminuar OE-në.” Vendimi për anulim ka qenë i njëjtë për të dy lotët. Shkaku ka qenë mungesa e mjeteve financiare dhe jo OE-ja. Nuk ka asnjë element për trajtim të pabarabartë ose diskriminim.

Raportin e ekspertizës me nr.1237/2025 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Raportin e ekspertizës me nr.1250/2025 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit shqyrtues, parashtrësat dhe dokumentet e ankuesve, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE PRO MEDICAL SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1237 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës:

Autoriteti Kontraktues me datë 23.09.2025 ka publikuar në eprokurim aktivitetin e prokurimit “ Servisimi dhe mirëmbajtja e paisjeve mjekësore për nevojat e QKMF Dr. Safet idrizi Vushtrri ” me numër të prokurimit 644-25-8559-2-2-1, ky aktiviteti është i ndarë në dy (2) Pjesë të ndryshme: Pjesa 1: SERVISIMI, MIRËMBAJTJA E PAJISJEVE MJEKËSORE - APARATURAVE LABORATORIKE NË QKMF VUSHTRRI dhe Pjesa 2: SERVISIMI, MIRËMBAJTJA E PAJISJEVE MJEKËSORE - APARATURAVE STOMATOLOGJI, URGJENCË, MJEKËSI FAMILJARE NË QKMF VUSHTRRI

Me datën 13/10/2025 është bërë hapja e ofertave. Sipas ankesës së dorëzuar nga OE ankues thekson se për këtë aktivitet të prokurimit ka bërë kërkesë për rishqyrtim me datën 03.11.2025 kundër vendimit të AK-së si ofertë e pa përgjegjshme për Pjesën 1 që do të thotë se OE ankues ka bërë kërkesë për rishqyrtim vetëm për Pjesën 1. Autoriteti Kontraktues në vendimin për

shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim ka aprovuar pjesërisht kërkesën për rishqyrtim dhe aktivitetin e prokurimit është kthyer në rivlersim. Për më tepër shih B58 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të datës 29/10/2025.

Përgjigje në Pretendime -Eksperti shqyrtues pasi që ka analizuar pretendimin e OE ankues dhe të gjithë faktet se si ka rrjedhur procedura e këtij aktiviteti të prokurimit konstaton se autoriteti kontraktues ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit sipas dispozites ligjore të nenit 62 të Ligjit për Prokurimin Publik, pika 1 paragrafi 1.1 një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit. Sipas mendimit të ekspertit shqyrtues ky anulim nuk është konforme nenit 62 të LPP-së pika 1 paragrafi 1.1 pasi që situata e krijuar në mungesë të fondeve/mjeteve financiare për vitin 2025 në Autoritetin Kontraktues nuk i përket me bazen ligjore që i është referuar AK. Aktiviteti i prokurimit është kontratë kornizë për 36 muaj ku kriteri për dhënien e kontratës është Çmimi më i ulët i peshuar për më tepër shih foton si më poshtë

Nga kjo kur AK kanë aktivitet të prokurimit kontratë kornizë për 36 muaj me kriter të dhënies së kontratës më çmimi me u ulët i peshuar ku sasia për artikuj është 1 AK nuk janë të obliguar që ti blejnë shërbime por blerja apo kryerja e shërbimeve do të bëhet sipas nevojave dhe mjeteve financiare që ka në dispozicion për aktivitetin e prokurimit për të mirëmbajtjen e pajisjeve mjeksore që janë pjesë e këtij Aktiviteti të Prokurimit.

Sipas Ligjit të Prokurimit Publik, Neni 9 Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur pika 2. Nëse pas vlerësimit të nevojave, ZKA vendos se vlerësimi i nevojave e arsyeton ushtrimin e aktivitetit të prokurimit, ZKA i dërgon një kopje të këtij vlerësimi ZKF të autoritetit kontraktues. ZKF siguron se ka mjete financiare në dispozicion për prokurimin përkatës. Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore, ZKF në pajtim me dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publik dhe Përgjegjësitë dhe Rregullat Financiare do të sigurojë nëse janë ndarë mjete të mjaftueshme financiare për prokurimin përkatës në shumë të mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve që mund të dalin si rezultat i prokurimit në fjalë gjatë vitit aktual fiskal.

3. Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore dhe prokurimi përkatës do të shkaktojë ngritjen e obligimeve financiare të cilat do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme fiskale, ZKF do të (i) sigurojë që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet e ardhshme fiskale do t'i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla (ii) të përfshijë në kontratën përkatëse publike një dispozitë që qartësisht e kushtëzon zbatueshmërinë e obligimeve të parashtruara në kontratë, me legjislacionet e ardhshme të përvetësimeve, të fondeve me qëllim të përmbushjes, dhe në një shumë të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla.

Sipas pikës 3 kur kontrata kornizë është më shumë se një vitë fiskal ZKF do të (i) sigurojë që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet e ardhshme fiskale do t'i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla (ii) të përfshijë në kontratën përkatëse publike një dispozitë që qartësisht e kushtëzon zbatueshmërinë e obligimeve të parashtruara në kontratë, me legjislacionet e ardhshme të përvetësimeve, të fondeve me qëllim të përmbushjes, dhe në një shumë të mjaftueshme për

përmbushjen e obligimeve të tilla. Nga kjo arsytimi i Autoriteti Konstruktues se nuk ka mjeteve financiare për vitin 2025 nuk përkon më nenin 9 pika 3 si më lartë pasi që aktiviteti i prokurimit është kontratë kornizë për 36 muaj dhe se mjetet financiare mund të sigurohen për vitet në vijim. Nga kjo mendojë se anulimi i këtij Aktiviteti të Prokurimit nuk është konforme Ligjit të Prokurimit Publik neni 62 pika 1 paragrafi 1.1 pasi që arsytimi në munges të mjeteve financiare për vitin fiskal 2025 nuk është sipas nenit të lartë shenuar.

Gjithashtu edhe neni 43 paragrafi 5 dhe paragrafi 7 i Rregullores Nr.002/2024 për Plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik , i parasheh arsyet se kur mund të bëhet anulimi i aktivitetit të prokurimit pas hapjes së tenderëve:

43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:

- a. asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;
- b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;
- c. numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3(tre);
- d. nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
- e. numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;
- f. nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar; g. asnjë nga projektet e pranura në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;
- h. nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit; i. një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;
- j. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes se procedures ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; ose
- k. nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.

43.7 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme:

- a. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK.

Nga dispozitat e lartpërmendura dhe nga rrjedha e këtij aktiviteti të prokurimit eksperti shqyrtues mendon se nuk është përmbushur asnjëra nga kushtet e nenit 62 të Ligjit të Prokurimit Publik si dhe nenit 43.5 dhe 43.7 të Rregullores Nr.002/2024 për Plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Andaj, duke u bazuar në dokumentacionin e këtij aktiviteti të prokurimit, eksperti shqyrtues mendon se pretendimi i OE ankues se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit Pjesa 1 është bërë në mënyrë kundërligjore sipas sqarimeve të lartë shenuar më sipër.

Duke ju referuar fakteve e sipër permendurë me lartë nga ankuesi si dhe sqarimeve të dhëna më lartë , mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është i bazuar.

Lidhur me pretendimet e OE PRO MEDICAL SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1250 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues me datë 23.09.2025 ka publikuar në eprokurim aktivitetin e prokurimit “ Servisimi dhe mirëmbajtja e paisjeve mjekësore për nevojat e QKMF Dr. Safet idrizi Vushtrri ” me numër të prokurimit 644-25-8559-2-2-1, ky aktiviteti është i ndarë në dy (2) Pjesë të ndryshme: Pjesa 1: SERVISIMI, MIRËMBAJTJA E PAJISJEVE MJEKËSORE - APARATURAVE LABORATORIKE NË QKMF VUSHTRRI dhe Pjesa 2: SERVISIMI, MIRËMBAJTJA E PAJISJEVE MJEKËSORE - APARATURAVE STOMATOLOGJI, URGJENCË, MJEKËSI FAMILJARE NË QKMF VUSHTRRI

Me datën 13/10/2025 është bërë hapja e ofertave. Sipas B58 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES i datës 29/10/2025, OE “ Pro Medical ” është rekomanduar për kontratë për Pjesën 2 si ofertë e vetme që ka ofertuar për këtë Pjesë 2. Ndërsa me rastin e kthimit të aktivitetit të prokurimit në rivlerësim pasi që për Pjesën 1 kan pranuar kërkesë për rishqyrtim AK ka anuluar komplet aktivitetin duke përfshirë edhe Pjesën 2:SERVISIMI, MIRËMBAJTJA E PAJISJEVE MJEKËSORE - APARATURAVE STOMATOLOGJI, URGJENCË, MJEKËSI FAMILJARE NË QKMF VUSHTRRI. Sipas B58 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të datës 29/10/2025 të publikuar nga AK verëhet se për Pjesën 2 kan pranuar vetëm një (1) ofertë të pranuar për më tepër shih foton

Nga fotoja e më sipërme te B58 Njoftim mbi Vendimin e AK-së për Pjesën 2 është pranuar vetëm një (1) ofertë ku sipas AK kjo ofertë ka qenë e përgjegjshme që i plotëson të gjitha kriteret e kerkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. AK pas skadimit të afateve ligjore për kërkesë për rishqyrtim ka pas për obligim që të vazhdoj me tutje për Pjesën 2 duke vazhduar me publikimin e Njoftimit për dhënie të kontratës dhe të bëjë nënshkrimin e ë për Pjesën 2, pasi që për Pjesën 2 nuk ka pranuar asnjë kerkesë për rishqyrtim pasi qe për këtë Pjesë është pranuar një (1) ofertë e jo të bëjë anulimin e aktivitetit të prokurimit në terësi që është në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik neni 62. Vlenë të theksohet se dosja e tenderit e përgaditur me më shumë Pjesë/Lote përbenë që çdo Pjesë/Lot është kontratë në vete e në këtë rast Pjesa 2 është kontratë në vete pasi që për këtë pjesë nuk është pranuar asnjë kerkesë për rishqyrtim.

Përgjigje në Pretendime Eksperti shqyrtues pasi që ka analizuar pretendimin e OE ankues për Pjesën 2 dhe të gjithë faktet se si ka rrjedhur procedura e këtij aktiviteti të prokurimit konstaton se Autoriteti Kontraktues ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit sipas dispozites ligjore të nenit 62 të Ligjit për Prokurimin Publik, pika 1 paragrafi 1.1 një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit. Sipas mendimit të ekspertit shqyrtues ky anulim nuk është konforme nenit 62 të LPP-së pika 1 paragrafi 1.1 pasi që situata e krijuar në munges të fondeve/mjeteve financiare për vitin 2025 në Autoritetin Kontraktues nuk i përketë me bazen ligjore që i është referuar AK. Aktiviteti i prokurimit është kontratë kornizë për 36 muaj ku kriteri për dhënien e kontratës është Çmimi më i ulët i peshuar për më tepër shih foton si më poshtë Nga kjo kur AK kanë aktivitet të prokurimit kontratë kornizë për 36 muaj me kriter të dhënies së kontratës më çmimi me u ulët i peshuar ku sasia për artikuj është 1 AK nuk janë të obliguar që ti blejn shërbime por blerja apo kryerja e shërbimeve do të behët sipas

nevojave dhe mjeteve financiare që ka në dispozicion për aktivitetin e prokurimit për të mirembajtjen e pajisjeve mjeksore që janë pjesë e këtij Aktiviteti të Prokurimit. Sipas Ligjit të Prokurimit Publik, Neni 9 Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur pika 2. Nëse pas vlerësimit të nevojave, ZKA vendos se vlerësimi i nevojave e arsyeton ushtrimin e aktivitetit të prokurimit, ZKA i dërgon një kopje të këtij vlerësimi ZKF të autoritetit kontraktues. ZKF siguron se ka mjete financiare në dispozicion për prokurimin përkatës. Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore, ZKF në pajtim me dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publik dhe Përgjegjësitë dhe Rregullat Financiare do të sigurojë nëse janë ndarë mjete të mjaftueshme financiare për prokurimin përkatës në shumë të mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve që mund të dalin si rezultat i prokurimit në fjalë gjatë vitit aktual fiskal.

3. Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore dhe prokurimi përkatës do të shkaktojë ngritjen e obligimeve financiare të cilat do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme fiskale, ZKF do të (i) sigurojë që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet e ardhshme fiskale do t'i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla (ii) të përfshijë në kontratën përkatëse publike një dispozitë që qartësisht e kushtëzon zbatueshmërinë e obligimeve të parashtruara në kontratë, me legjislacionet e ardhshme të përvetësimeve, të fondeve me qëllim të përmbushjes, dhe në një shumë të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla.

Sipas pikës 3 kur kontrata kornizë është më shumë se një vitë fiskal ZKF do të (i) sigurojë që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet e ardhshme fiskale do t'i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla (ii) të përfshijë në kontratën përkatëse publike një dispozitë që qartësisht e kushtëzon zbatueshmërinë e obligimeve të parashtruara në kontratë, me legjislacionet e ardhshme të përvetësimeve, të fondeve me qëllim të përmbushjes, dhe në një shumë të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla. Nga kjo arsytimi i Autoriteti Kontraktues se nuk ka mjeteve financiare për vitin 2025 nuk përkon më nenin 9 pika 3 si më lartë pasi që aktiviteti i prokurimit është kontratë kornizë për 36 muaj dhe se mjetet financiare mund të sigurohen për vitet në vijim.

Nga kjo vërehet se anulimi i këtij Aktiviteti të Prokurimit nuk është konforme Ligjit të Prokurimit Publik neni 62 pika 1 paragrafi 1.1 pasi që arsytimi në mungesë të mjeteve financiare për vitin fiskal 2025 nuk është sipas nenit të lartë shenuar.

Sipas Rregullores Nr. 001/2022 i plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024

Gjithashtu edhe neni 43 paragrafi 5 dhe paragrafi 7 i Rregullores Nr.002/2024 për Plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik , i parasheh arsyet se kur mund të bëhet anulimi i aktivitetit të prokurimit pas hapjes së tenderëve:

43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:

a. asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar; b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm; c. numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3(tre); d. nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar; e. numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se

3; f. nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar; g. asnjë nga projektet e pranuar në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm; h. nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit; i. një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi; j. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes së procedurës ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; ose k. nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.

43.7 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme: a. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK.

Nga dispozitat e lartpërmendura dhe nga rrjedha e këtij aktiviteti të prokurimit eksperti shqyrtues mendon se nuk është përmbushur asnjëra nga kushtet e nenit 62 të Ligjit të Prokurimit Publik si dhe nenit 43.5 dhe 43.7 të Rregullores Nr.002/2024 për Plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Sipas raportit të rivlerësimit të ofertave verëhet se AK ka rekomanduar për kontratë për të dy Pjesët 1 dhe 2 Operatorin Ekonomik “ Pro Medical ” që i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Për me tepër shih foton si në vijim:

Andaj, duke u bazuar në dokumentacionin e këtij aktiviteti të prokurimit, eksperti shqyrtues mendon se pretendimi i OE ankues se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit Pjesa 1 është bërë në mënyrë kundërligjore sipas sqarimeve të lartë shënuar më sipër.

Duke ju referuar fakteve e sipër përmendurë me lartë nga ankuesi si dhe sqarimeve të dhëna më lartë , mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është i bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit, konsideron se gjetjet e raportit të ekspertit shqyrtues vlerësimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatoreve ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues, andaj paneli shqyrtues pa nevojë për sqarime tjera shtesë e vlerëson si pjesërisht të bazuara ankesat e OE ankuesve të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së për anulim të aktivitetit, ndërkaq aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik PRO MEDICAL SH.P.K., aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me Servisini dhe mirëmbajtja e paisjeve mjekësore për nevojat e QKMF Dr. Safet idrizi Vushtrri. me numër të prokurimit 644-25-8559-2-1, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si të bazuar, duke sugjeruar që aktiviteti i prokurimit në fjalë të rivlerësohet dhe gjatë rivlerësimit AK të veproj në plotin me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik PRO MEDICAL SH.P.K., aprovohet e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Servisini dhe mirëmbajtja e paisjeve mjekësore për nevojat e QKMF Dr. Safet idrizi Vushtrri. me numër të prokurimit 644-25-8559-2-2-1, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si pjesërisht të bazuar, duke sugjeruar që aktiviteti i prokurimit në fjalë të rivlerësohet dhe gjatë rivlerësimit AK të veproj në plotin me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E VUSHTRISË, KOMUNA E VUSHTRISË**
- **OE - PRO MEDICAL SH.P.K., PRO MEDICAL SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: